REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E MJEDISIT

Masat e marra Progres Reporti 2014 Mbrojtja e Natyres

Drejtoria e Biodiversitetit dhe Zonave te Mbrojtura
Ministria e Mjedisit
7 Maj 2015

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E MJEDISIT

Harmonizimi I legjislacionit

- Ligji. 5/2015 of 12.02.2015 “Per nje ndryshim ne Ligjin No. 9867 of 31.01.2008 “Për përcaktimin e rregullave dhe të procedurave për tregtimin ndërkombëtar të llojeve të rrezikuara të florës dhe faunës së egër”;
- VKM nr. 866, datë 10.12.2014 “Për miratimin e listave të habitateve natyrore, bimëve, kafshëve dhe shpendëve me interes për Bashkimin Evropian”, që siguron transpozimin e e pjesshëm të Direktivës 92/43/EEC “Për ruajtjen e habitateve natyrore, florën dhe faunën e egër”, të ndryshuar nga Direktiva 97/62/EC, Direktiva 2006/105/EC dhe Rregullorja (EC) 1882/2003, si dhe Direktives 2009/147/EC “Për ruajtjen e shpendëve të egër”.

- Draft ligji “Për disa shtesa dhe ndryshime në Ligjin nr. 10253, datë 11.3.2010 “Për gjuetinë”” derguar ne KM dhe me pas ne Parlament

- Bazuar ne Ligjin nr. 7/2014 “Për Shpalljen e Moratoriumit të Gjuetisë në Republikën e Shqipërisë”, i cili ndalon gjuetinë për një periudhë dy vjeçare, qe nga16 Marsi 2014, u hartua një Plan Veprimi për zbatimin e tij I miratuar nga Ministri i Mjedisit në 3 Korrik 2014.

Dokument strategjik

- Ka përfunduar rishikimi dhe përditësimi i “Strategjisë dhe Planit të Veprimit për Biodivesitetin për periudhën 2015-2020”, në kuadër të projektit “Rishikimi i SPVB për Shqipërinë” me mbështetjen e Fondit Global të Mjedisit (GEF). Aktualisht, Strategjia Kombëtare e Biodiversitetit është dërguar për miratim në KM.

- Është në zbatim projekti tjetër i GEF “Hartimi i Planit Kombëtar të Veprimit të Harmonizuar me Planin Strategjik të Konventës së Kombeve të Bashkuara për të Luftuar Shkretëtirëzimin (UNCCD) dhe Përgatitja e Raportit Kombëtar për Konventën”. Eshte në proces përgatitja e Planit Kombëtar të Veprimit për Shqipërinë.

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E MJEDISIT

Kuadri institucional

- **Ne Shkurt 2015 eshte krijuar Agjencia Kombetare e Zonave te Mbrojtura (AKZM)**, miratuar me VKM nr. 102, date 4.02.2015 “Per Krijimin dhe Menyren e Organizimit e te Funksionit te Agjencise Kombetare te Zonave te Mbrojtura dhe te Administratave Rajonale te Zonave te Mbrojtura”.

Krijimi i AKZM-se ka per qellim ruajtjen dhe kujdesin ndaj natyres e biodiversitetit, nepermjet menaxhimit te rrjetit te zonave te mbrojtura me interes kombetar e nderkombetar, mbledhjes dhe shperndarjes se informacionit, edukimit mjedisor dhe ndergjegjesimit te publikut per zonat e mbrojtura dhe mbeshtetjes se aktiviteteve te qendrueshme ekonomike brenda ketyre zonave.

- **VKM nr. 39 of 12.03.2015 “Per miratimin e struktures dhe organigrames se AKZM dhe ADZM”** percakton numrin total te punonjesve ne 224. (12 ADZM)

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E MJEDISIT

Protected Areas effectiveness

Per nje mbrojtje efektive te zonave te shpallura te mbrojtura gajte kesaj periudhe jane miratuar 5 Plane Menaxhimi per Zonat e Mbrojtura:

- Urdhër i Ministrit të Mjedisit nr. 2025, datë 31.12.2014 “Për miratimin e Planit të Menaxhimit të Parkut Kombëtar Bredhi Hotovës-Dangëlli”;
- Urdhër i Ministrit të Mjedisit nr. 2026, datë 31.12.2014 “Për miratimin e Planit të Menaxhimit të Peizazhit të Mbrojtur Pogradec”;
- Urdhër i Ministrit të Mjedisit nr. 2027, datë 31.12.2014 “Për miratimin e Planit të Menaxhimit të Parkut Kombëtar Mali i Tomorrit”;
- Urdhër i Ministrit të Mjedisit nr. 2028, datë 31.12.2014 “Për miratimin e Planit të Menaxhimit të Peizazhit të Mbrojtur Mali me Gropa-Bizë-Martanesh”;
- Urdhër i Ministrit të Mjedisit nr. 2029, datë 31.12.2014 “Për miratimin e Planit të Menaxhimit të Parkut Natyror Korab-Koritnik”.

Ndërkohë janë në proces hartimi Planet e Menaxhimit për zonat e mbrojtura të mëposhtme:

- Parku Kombëtar Shebenik – Jabllanicë
- Peizazhi i Mbrojtur Lumi Buna – Velipojë;
- Parku Kombëtar Alpet në bashkëpunim me projektin CABRA I dhe projektin IPA ECRAN

Planet e Menaxhimit per PK Shebenik-Jabllanice dhe PM Lumi Buna Velipoje do te miratohen brenda vitit 2015 ndersa ai I Alpeve brend 2016

- Për vitin 2015 u alokuan 40.4 milione lekë për zbatimin e aktiviteteve prioritare të Planeve të menaxhimit në dy Zona të Mbrojtura. Janë hartuar projektet e zbatimit dhe është në proces praktika për fillimin e zbatimit të këtyre punimeve.

- Në zbatim të Ligjit nr.7/2014 “Për Shpalljen e Moratoriumit të Gjuetisë në Republikën e Shqipërisë”, gjatë kesaj periudhe janë vendosur 17 gjoba me vlerë 9143 Euro, dhe jane sekuestruar 17 arme gjuetie te perdorura ilegalisht.

- Në kontekstin e zbatimit të EU *acquis* të transpozuar ka filluar nga projekti IPA 2013 Natura 2000, që synon të realizojë studimin për identifikimin e listës paraprake të zonave që plotësojnë kriteret për t’u shpallur zona më rëndësi për BE-në (Sites of Community Importance) për Shqipërinë.

FALEMINDERIT !